



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot B. prot Prot No	01-807/15
Data Datum Date	19-03-2015
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.03.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 - 02-3926/14, për z. Sabri Halili – Gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK - 03 - 3926/14, për zyrtarin e lartë z. Sabri Halili – Gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Halili është hetuar për konflikt të mundshëm interesi për shkak se, krahas ushtrimit të funksionit publik si gjyqtar, ishte edhe pronar në biznesin privat “Kodeks” dhe person i autorizuar në biznesin tjetër privat “Avokat Sabri Halili”.

Fillimisht ai është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë, për t’i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëjë në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Halili është bindur për kufizimin e të qenurit pronar, respektivisht person i autorizuar në biznesin privat dhe ka premtuar që do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresat zyrtare, të lëshuara nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 02/74/15 dhe 03-02/768/15), me të cilat vërtetohet se ka bërë ndryshimet e nevojshme. Me këtë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

